

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NM.49. Prot.

Tiranë, m&F.11. 2017 (Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA:

NJOFTIM MBI APLIKIMET NË PROGRAMIN E FONDIT TË EKSELENCËS PËR VITIN AKADEMIK

2018-2019

DREJTUAR:

DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE

Tirana Qark

ZYRËS ARSIMORE

Të nderuar drejtorë,

Bashkëlidhur gjeni njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë mbi aplikimet në programin e Fondit të Ekselencës, për vitin akademik 2018-2019.

Për sa më sipër, merrni e masat e nevojshme për njoftimin e të interesuarve dhe bërjen publike të njoftimit në faqen zyrtare dhe mjediset e institucionit tuaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOLI BELE

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 42230244 Fax: +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al Web site: www.arsimi.gov.al



MBI APLIKIMET NË

PROGRAMIN E FONDIT TË EKSELENCËS PËR VITIN AKADEMIK 2018 – 2019

NË VËMENDJE TË DREJTORIVE/ZYRAVE ARSIMORE RAJONALE

Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit të Ekselencës, dhënë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kontribuon çdo vit me një fond prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë lekë) për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, të cilët janë pranuar të kryejnë studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" jashtë vendit në një nga 15 universitetet më të mira të botës, sipas renditjes së "Times Higher Education" – Renditja botërore e universiteteve.

Bazuar në Vendimin Nr. 483, datë 16.07.2014 të Këshillit të Ministrave "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)" dhe Udhëzimin Nr. 16, datë 01.08.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", dokumentacioni, afatet e aplikimit, kriteret dhe procedurat mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e kandidatëve, janë sa më poshtë:

- 1. Kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët, që aplikojnë për vitin e parë të studimeve të ciklit të parë "Bachelor dhe programet e integruara të ciklit të dytë, janë të parashikuara në Vendimin Nr. 483, datë 16.07.2014 të Këshillit të Ministrave "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)" dhe Udhëzimin Nr. 16, datë 01.08.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", sa më poshtë:
 - 1.1. Të jenë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike sipas fushave, nga "Times Higher Education"- Renditja botërore e universiteteve, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit, ose të kenë përfituar financim/bursë në masën 75 për qind të shpenzimeve totale të parashikuara nga universiteti pritës (për tarifën e shkollimit dhe kosto të tjera të jetesës) në rastet kur universiteti është i akredituar dhe i mirënjohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në rastin e dytë mbështetja financiare nga Fondi i Ekselencës nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 euro në vit;
 - 1.2. Të pranojnë të punojnë, së paku, 3 (tre) vjet në Shqipëri, pas diplomimit në ciklin përkatës të studimeve për të cilin përfitojnë bursën ose pas përfundimit të të gjithë cikleve të studimit, nëse kandidati fitues vijon studimet në ciklet më të larta universitare;
 - 1.3. Të jenë shtetas shqiptarë;
 - 1.4. Të mos jenë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar;
 - 1.5. Të kenë përfunduar studimet para universitare me mesatare mbi 9 (nëntë), të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit, për studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve universitare;
- 2. Afatet për aplikimet, për kandidatët që ndjekin vitin e parë të studimeve për këtë vit akademik, do të ndahen në dy faza:
 - 2.1. Fazën e parë afati i dorëzimit të dokumenteve është nga data 1 Mars 30 Prill 2018;
 - 2.2. Faza e dytë nga data 1 Gusht 30 Shtator 2018.

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 42230244 Fax: +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al Web site: www.arsimi.gov.al 3. Dokumentacioni, që duhet të paraqesë kandidati:

- 3.1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MAS: www.arsimi.gov.al);
- 3.2. Kopje të pasaportës/ kartës së identitetit;
- 3.3. Vërtetim të qendrës së banimit;
- 3.4. CV e hollësishme, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV;
- 3.5. Dokument që vërteton përfundimin me sukses të studimeve të shkollës së mesme (dëftesë pjekurie, certifikatë e maturës shtetërore, etj). Këto dokumente duhet të dorëzohen si fotokopje të noterizuara;
- 3.6. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë, (origjinale ose fotokopje e noterizuar):
- 3.7. Planin e studimit për programin që do të ndjekë kandidati në universitetin pritës;
- 3.8. Një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar).
- 3.9. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MAS dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose te huaja të paraqitet kopje e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose te huaja (përjashtuar ato shtetërore).
- 3.10. Tri rekomandime origjinale për cilësitë e kandidatit.

Informacionet sa më sipër, janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rubrika "Fondi i Ekselencës".

http://www.arsimi.gov.al/al/arsimi/universiteti/fondi-ekselences.

Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me e-mail në adresën elektronike: fondi.ekselenca@arsimi.gov.al.

Po kështu, Sekretariati Teknik i Programit do të zhvillojë takime me të interesuarit çdo ditë të mërkurë, gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor në mjediset e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 42230244 Fax: +355 4 42230244

Email: <u>info@arsimi.gov.al</u> Web site: www.arsimi.gov.al